# "PIRRO" sh.p.k

Selia: Gjin Bue Shpata

Tirane – Albania

## Pasqyrat Financiare për periudhën e mbyllur me 31 Dhjetor 2018

Tirane, 31 Mars 2019

## Përmbajtja


1. Bilanci Kontabël
2. Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve
3. Pasqyra e flukseve monetare
4. Pasqyra e ndryshmeve në kapital
5. Shënime


PIRRO
ARTISTIC JEWELLERY

## Pasqyra e Situatës Financiare datë 31 Dhjetor 2018

| AKTIVET | Shen | 2018 | 2017 |
|---|---|---|---|
| **Aktivet Afatshkurtëra** | | | |
| **Aktive monetare** | 4 | **2,817,388** | **3,812,301** |
| **Aktive të tjera financiare afatshkurtra** | | | |
| *Llogari/Kërkesa të arkëtueshme* | 5 | 7,814,572 | 5,896,160 |
| *Llogari/Kërkesa të tjera të arkëtueshme* | 6 | 46,915 | 801,633 |
| **Totali 3** | | **7,861,488** | **6,697,792** |
| **Inventari** | | | |
| *Lëndët e para* | 7 | 37,728,735 | 34,981,428 |
| *Prodhim në proces* | 7 | 0 | 0 |
| *Produkte të gatshme* | 7 | 22,475,306 | 21,665,587 |
| *Materiale te tjera Inventar I imet* | 7 | 2,521,168 | 0 |
| **Totali 4** | | **62,725,209** | **56,647,015** |
| **Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra** | 8 | 123,755 | 2,772,508 |
| **Total i Aktiveve Afatshkurtra (I)** | | **73,527,840** | **69,929,616** |
| **Aktivet afatgjata** | | | |
| **Aktive afatgjata materiale** | | | |
| Toka | 9 | 22,612,350 | 22,612,350 |
| *Ndërtesa* | 9 | 52,413,777 | 52,851,228 |
| *Makineri dhe pajisje* | 9 | 67,643,271 | 78,126,390 |
| *Aktive të tjera afatgjata materiale (me vl.kontab.)* | 9 | 6,762,924 | 12,536,083 |
| *Parapagime per aktive afatgjata materiale* | 9 | 6,943,475 | 0 |
| **Totali 2** | | **156,375,797** | **166,126,051** |
| **Totali i aktiveve Afatgjata (II)** | | **156,375,797** | **166,126,051** |
| **TOTALI I AKTIVEVE (I + II)** | | **229,903,637** | **236,055,667** |
| | | | |
| **DETYRIMET DHE KAPITALI** | | | |
| **DETYRIMET Afatshkurtëra** | | | |
| **Huamarrjet** | | | |
| *Huat dhe obligacionet afatshkurtra* | 10 | 11,944,515 | 0 |
| **Huat dhe parapagimet** | | | |
| *Të pagueshme ndaj furnitorëve* | 11 | 5,675,595 | 3,080,189 |
| *Të pagueshme ndaj punonjësve* | 12 | 1,003,783 | 948,602 |
| *Detyrime tatimore* | 13 | 1,489,277 | 567,432 |
| *Hua të tjera* | 14 | 57,694,812 | 56,524,431 |
| *Parapagimet e arkëtuara* | 14.1 | - | - |
| **Totali i detyr. afatshkurtra (I)** | | **77,807,982** | **61,120,654** |
| | | | |
| **DETYRIME AFATGJATA** | | - | - |
| *Huamarrje të tjera afatgjata* | 16 | 50,625,808 | 76,007,596 |
| **Totali i detyr. afatgjata (II)** | | **50,625,808** | **76,007,596** |
| **Totali i detyrimeve** | | **128,433,790** | **137,128,251** |
| | | | |
| **Kapitali** | | | |
| Kapitali aksionar | 16 | 61,000,000 | 61,000,000 |
| Rezerva ligjore | 16 | 9,752,179 | 9,752,179 |
| Rezerva të tjera | 16 | 79,542 | 79,542 |
| Fitimet e pashpërndara | 16 | 28,095,695 | 24,465,447 |
| Fitimi (humbja) e vitit financiar | 16 | 2,542,432 | 3,630,248 |
| **Totali i kapitalit (III)** | | **101,469,848** | **98,927,417** |
| | | | |
| **TOTALI I DETYRIMEVE KAPITALIT** | | **229,903,638** | **236,055,667** |

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-24

PIRRO ARTISTIC JEWELLERY

## Pasqyra e të Ardhurave gjithpërfshirëse për periudhën që përfundon më 31.12.2018

### Pasqyra e dhe Shpenzimeve

**Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve**

| | Shen | Viti 2018 | 2017 |
|---|---|---|---|
| Shitjet neto | 17 | 100,531,261 | 106,377,215 |
| Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit | 17 | - | - |
| Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatëshme dhe prodhimit në proces | | 809,719 | -4,555,428 |
| Materialet e konsumuara . | 18 | -42,144,826 | -41,367,198 |
| Kosto e punës | 19 | - | - |
| -pagat e personelit - | 19 | -12,378,070 | -13,327,548 |
| -Shpenzimet per sigurimet shoqerore dhe shendetësore | 19 | -2,056,929 | -2,216,629 |
| Amortizimi dhe zhvleresimet | 9 | -21,045,959 | -23,444,797 |
| Shpenzime të tjera | 20 | -19,493,877 | -16,024,172 |
| **Totali i shpenzimeve** | | **-97,119,660** | **-96,380,344** |
| **Fitmi apo humbja nga veprimtaria kryesore** | | **4,221,320** | **5,441,443** |
| **Te Ardhura Te tjera** | | | |
| **Total Te Ardhura Te tjera** | | - | - |
| **Shpenzime financiare** | | | |
| Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme | 21 | -1,482,414 | -1,170,563 |
| Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi | 22 | 1,082,689 | - |
| Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare | 23 | - | - |
| **Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare** | | **-399,726** | **-1,170,563** |
| ***Fitimi (humbja) para tatimit*** | 24 | **3,821,595** | **4,270,880** |
| Shpenzimet e tatimit mbi fitimin | 24 | -1,279,163 | -640,632 |
| **Fitmi (humbja) neto e vitit financiar** | | **2,542,432** | **3,630,248** |
| **Të Ardhura të Tjera gjithpërfshirëse** | | | |
| Fitimi (Humbje) nga rivlerësimi i AAM | | - | - |
| Fitimi (Humbje) nga rivlerësimi i AAFinacniare | | | |
| **Totai i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse neto nga tatimet** | | | |
| **Totali i të ardhurave neto gjithpërfshirëse për periudhën** | | **2,542,432** | **3,630,248** |

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-24

Pasqyrat Financiare "Pirro shpk" janë aprovuar nga Drejtimi i Shoqërisë
Më datë 31 Mars 2019

**Hartuesi**
Irena Shehy

**Administratori**
Spiro Ruco
**Spiro Ruco**

PIRRO ARTISTIC JEWELLERY

*SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHE SHKRUHET*

# Pasqyra e ndryshimit të flukseve te mjeteve monetare për periudhën që përfundon më 31.12.2018

| | Shen | 2018 | 2017 |
|---|---|---|---|
| **Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit** | | | |
| **Fitimi para tatimit** | 23 | 3,821,595 | 4,270,880 |
| *Rregullime për:* | | | |
| Tatim Fitimin e Njohur ne PASH | 21 | -1,123,079 | 640,632 |
| Amortizimi i Aktive Afagjata | 9 | 21,045,959 | 23,444,797 |
| | | 23,744,474 | 28,356,309 |
| Rritje/rënie në tepricën e Llogari/Kërkesa të arkëtueshme | 5 | -1,918,413 | 4,776,881 |
| Rritje/rënie në tepricën e Llogari/Kërkesa të arkëtueshme te tjera | 6 | 598,633 | - |
| Rritje/rënie në tepricën inventarit | | -6,078,195 | -21,278,817 |
| Rritje/rënie në Shpenzimet e Shtyra | 8 | 2,648,754 | - |
| Rritje/rënie në tepricën e Llogarive te Pagueshme ( Furnitoreve) | 11 | 2,595,406 | 15,132,594 |
| Rritje/Rënie në detyrimet ndaj punonjësve | 12 | 55,181 | - |
| Rritje/rënie në tepricën e Detyrimeve tatimore | 13 | 921,845 | - |
| Huamarrje afatshkurter - Overdraft | 10 | 11,944,515 | - |
| Rritje/rënie në Hua te tjera | 14 | 1,170,381 | - |
| Rritje/rënie në Parapagime te arketuara | 14.1 | - | -1,547,375 |
| Interesi i Paguar | 21 | - | - |
| Tatim mbi fitimin i paguar | | - | - |
| | | 11,938,108 | -2,916,717 |
| *MM Neto nga aktivitetet e shfrytëzimit* | | 35,682,582 | 25,439,592 |
| **Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese** | | | |
| Pagesa per Blerja e aktiveve afatgjata | 9 | -11,295,705 | 786,063 |
| Arketime nga shitja/nxjerrja Jashte perdorimit e aktiveve afatgjata materiale | | - | - |
| *MM neto, e përdorur në aktivitetet investuese* | | -11,295,705 | 786,063 |
| **Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare** | | | |
| Rritje/pakesime huamarrje afatgjata | 14 | -25,381,789 | - |
| *MM neto e përdorur në aktivitetet financiare* | | -25,381,789 | - |
| **Rritja/rënia neto e mjeteve monetare** | | -994,912 | 26,225,655 |
| **Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël** | | 3,812,301 | 3,558,037 |
| **Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël** | | 2,817,388 | 3,812,301 |

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-24

*SHUMAT NE LEKE, PERNDRYSHE SHKRUHET*

## Pasqyra e ndryshimit të kapitalit aksionar për periudhën Janar - Dhjetor 2018

| | Kapitali aksionar | Rezerva ligjore | Rezerva te tjera | Fitimi i Pashpërndarë | Totali |
|---|---|---|---|---|---|
| **Pozicioni më 31 dhjetor 2016** | 61,000,000 | 9,752,179 | 79,542 | 24,465,447 | 95,297,168 |
| Emetim i kapitalit aksionar | | | | | - |
| Fitimi (humbja) neto i periudhës kontabël | | | | 3,630,248 | 3,630,248 |
| Rritje/ Pakesim rezerva ligjore, te tjera | | | | | - |
| | | | | | 0 |
| **Pozicioni më 31 dhjetor 2017** | 61,000,000 | 9,752,179 | 79,542 | 28,095,696 | 98,927,417 |
| Emetim i kapitalit aksionar | 0 | | | | - |
| Fitimi (humbja) neto i periudhës kontabël | | | | 2,542,432 | 2,542,432 |
| Rritje/ Pakesim rezerva ligjore, te tjera | | | | | - |
| **Pozicioni më 31 dhjetor 2018** | 61,000,000 | 9,752,179 | 79,542 | 30,638,127 | 101,469,848 |

Pasqyrat Financiare janë të lexueshme së bashku me shënimet shpjeguese 1-24

PIRRO ARTISTIC JEWELLERY

## 1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria PIRRO sh.p.k, në vijim e quajtur "Shoqëria", është themeluar sipas aktit të themelimit më datën 01.02.2001. PIRRO sh.p.k është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Kapitali eshte ndare ne 1 kuota me vlere prej 61.000.000 lekë. Në datën e këtyre PF struktura e zotërimit të kapitalit paraqitet si vijon:

| Emri i ortakut | Numri i pjeseve | % e kapitalit |
|---|---|---|
| Spiro Ruco | 1 | 100 |
| **Totali** | **1** | **100** |

Shoqeria eshte e regjistruar si person juridik në Drejtorinë Rajonale Tatimore të Tiranes me NIPT K31419099E.

Më 31 Dhjetor 2018 shoqëria ka 37 punonjës.

Aktivitet kryesor i shoqërisë, është Import eksport,perpunim argjendi dhe ari, si unaza, varese,medaljone,zinxhire,vathe etj. Prodhim te suvenireve me baker,argjend, te lara ne ar ose argjend. Punime medalje.
Administratori ligjor i shoqërisë është Z. Sipro Ruco.
Adresa e Shoqërisë është : Gjin Bue Shpata, Tirane, Shqiperi.

## 2. Parimet e pergatitjes se pasqyrave financiare

### (a) Deklarata e parimeve kontabel

Shoqëria mban regjistrimet kontabël dhe përgatit pasqyrat financiare në perputhje me legjislacionin kontabël në Shqipëri.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në perputhje me Ligjin nr. 9228 date 29 Prill 2004 "Për kontabilietin dhe pasqyrat financiare" dhe Standardet Kombetare te Kontabilitetit 1-14 (SKK) të përmirësuara të shpallura me urdhërin e Ministrit të Financave nr 64 dt 22.07.2014.

### (b) Parimet e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit te kostos historike.

Politikat kontabël janë zbatuar në përputhje me kërkesat e SKK të përmirësuara dhe të ligjit nr. 9228 date 29 Prill 2004 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe paraqiten në shënimin vijues.

## 3. Politikat kontabël kryesore

Nje permbledhje te pjeses me te madhe te politikave kontabel mbi bazen e te cilave jane pergatitur pasqyrat financiare jane paraqitur sa me poshte:

### 3.1 Transaksionet me monedhat e huaja

a. Konvertimi i transaksioneve në monedhë të huaj

*i) Monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes*

Zërat e përfshirë në pasqyrat financiare vlerësohen duke përdorur monedhën e mjedisit ekonomik kryesor në të cilin operon njësia ( "monedha funksionale"). Pasqyrat financiare në Shqipëri paraqiten në Lekë (All), e cila është monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes.

*ii) Transaksionet dhe tepricat*

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në fund të periudhës kontabël, aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit të kësaj datë. Diferencat nga konvertimi, fitimet ose humbjet, paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, në zërin "Të tjera të ardhura/shpenzime" për diferencat e lidhura me kërkesat për t'u arkëtuar dhe detyrimet ndaj furnitorëve, dhe në zërin "Fitime/humbje nga këmbimi" në rastin e mjeteve monetare.

Kurset e këmbimit të përdorura për konvertimin e zërave monetarë në datën 31 Dhjetor 2018 janë:

| Data / Monedha | 31 Dhjetor 2018 | 31 Dhjetor 2017 |
|---|---|---|
| Euro | 123.42 | 132.95 |
| USD | 107.82 | 111.10 |

## 3.2 Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre perfshijne MM ne arke dhe ato te mbajtura ne banka. Në përputhje me SKK 7 "Pasqyra e fluksit të Mjeteve Monetare", Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në pasqyrat e fluksit të Mjeteve Monetare përfshin MM (arkëtimet në MM dhe depozitat me afat) dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare (investimet afat-shkurtra, nëse ka, të cilat janë shumë likuide dhe menjëherë të konvertueshme në një vlerë që njihet me siguri dhe vlera e të cilave ndryshon shumë pak).
Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në pasqyrën e fluksit të Mjeteve Monetare nuk përfshin investimet në letrat me vlerë të listuara, investimet me një datë maturimi fillestare afati i të cilës është mbi tre muaj dhe pa një klauzolë përfundimi më të hershëm të këtij afati, ose llogaritë bankare që kanë kufizime në përdorim, kufizime këto të ndryshme nga ato të cilat janë si pasojë e rregullimeve specifike në një shtet ose sektorë të aktiviteteve (kontrollet e këmbimit, etj). Overdraftet bankare konsiderohen si financim dhe si rrjedhim përjashtohen nga Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare. Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në bilancin kontabël korespondojnë me Mjetet monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare sipas përkufizimit të mësipërm.

## 3.3 Aktivet financiare

Shoqëria i klasifikon aktivet financiare në Llogaritë e Arkëtueshme nga Klientat dhe në Kërkesa të tjera të Arkëtueshme. Manaxhimi vendos për klasifikimin në momentin e njohjes fillestare. Aktivet financiare paraqiten në bilanc me vlerën neto nga zhvlerësimi nëse ka. Llogari të Arkëtueshme njihen si aktive atëherë kur njësia ekonomike bëhet palë e një kontrate dhe, si rrjedhim, ka një të drejtë ligjore për të marrë mjete monetare nga klientat e saj.

Njohja fillestare e kërkesave për t'u arkëtuar nga klientat ndodh derisa mallrat ose shërbimet e porositura janë nisur për tek klienti, kanë mbërritur tek klienti dhe jane pranuar prej tij, ose shërbimi është kryer. Kërkesat për tu arkëtuar vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuara me koston e amortizuar (kosto fillestare minus arkëtimet e bëra, minus zhvlerësimet nga borxhi i keq nëse ka) pavarësisht nga qëllimi i njësisë për t'i mbajtur ato deri në maturim.

PIRRO ARTISTIC JEWELLERY

### 3.3 Aktivet financiare-vazhdim

Një zhvlerësim për rënie vlere të të drejtave për t'u arkëtuar krijohet atëherë kur është evidente që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje që t'i arkëtojë të gjitha shumat ashtu siç ishte parashikuar në termat fillestare të kërkesave për tu arkëtuar. Konsiderohen tregues të rënies së Vlerës së Llogarive të Arkëtueshme: Vështirësi të rëndësishme financiare të debitorit, ndoshta debitori ka hyrë në rrugën e falimentimit ose riorganizimit financiar, dhe moskryerja apo vonesat në pagesa.

Shoqëria vlerëson cdo vit mundësinë e arkëtimit të llogarive të arkëtushme për secilin klient apo debitor dhe kur një Llogari e Arkëtueshme vlerësohet që nuk mund të arkëtohet, ajo regjistrohet në shpenzimet dhe në Llogarinë e kërkesave të Arkëtueshme. Nëse më pas arkëtohet shuma të cilat janë çrregjistruar, atëherë kreditohen shpenzimet e shitjes dhe administrimit për këto shuma. Shuma e zhvlerësimit ëshë diferenca midis vlerës neto kontabël të aktivit dhe vlerës neto aktuale të flukseve të ardhsme të vlerësuar, të diskontuara me normën e interesit efektive. Shoqëria nuk ka llogaritur zhvlerësim të klientëve për vitin raportues

### 3.4 Inventarët

Inventarët njihen, në përputhje me përcaktimet e bëra në SKK 4 "Inventarët", kur shoqëria i kontrollon apo zotëron ato ekonomikisht apo ligjërisht, kur mbart të gjitha reziqet dhe përfitimet në lidhje me to, dhe kur kostoja matet në mënyrë të besueshme.
Në hyrje inventarët e mallrave dhe materialeve vlerësohen me koston e tyre që përfshin tërësinë e çmimeve të blerjes dhe të shpenzimeve të bëra deri në sjelljen e tyre në shoqëri kur këto kosto mund të indentifikohen me besueshmëri. Produktet e gatshme vlerësohen në hyrje me koston e prodhimit të tyre (duke përfshirë shpenzimet indirekte të prodhimit nëse është rasti). Në bilanc inventarët paraqiten të vlerësuara me vlerën neto, pra më të voglën midis kostos (dhe vlerës neto të realizueshme). Kostoja matet me metodën e mesatares se ponderuar. Vlera neto e realizueshme është e ardhura e parashikuar nga shitja në një periudhë normale të aktivitetit minus kostot e parashikuara të shitjes. Shiko shen. 7

### 3.5 Aktivet e Afatgjata Materiale (AAM)

*(i) Njohja dhe vleresimi*

AAM vlerësohen në hyrje me kosto historike. AAM paraqiten në Bilanc me koston e amortizuar (koston historike minus amortizimin e akumuluar minus zhvlerësimin nga ulja e vlerës (nëse ka). Kosto historike përfshin shpenzimet që i përkasin direkt blerjes së elementëve. Kostot e kryera më vonë përfshihen në vlerën e mbartur të aktivit ose njihen si një aktiv më vete, sipas rastit, vetëm nëse është e mundshme që ky element të sjellë hyrje të përftimeve të ardhshme ekonomike në shoqëri dhe kostoja e këtij elementi të mund të matet me besueshmëri. Të gjitha shpenzimet e mirëmbatjes dhe riparimit regjistrohen si shpenzime në periudhën që ato kryhen dhe paraqiten në zërin e shpenzimeve operative.

*(ii) Amortizimi*

Amortizimi i AAM llogaritet dhe njihet në pasqyren e të ardhurave dhe shpenzimeve me metoden e vleres se mbetur me norma te cilat jane te peraferta me jetegjatesine mesatare te parashikuar te perdorimit. Toka dhe aktivet në proces nuk amortizohen.

Normat mesatare të amortizimit per grupe të AAM, të përdorura në ndërtimin e PF për AAM në kontroll të shoqërisë jane te paraqitura si me poshte:

PIRRO
ARTISTIC JEWELLERY

### 3.5 Aktivet e Afatgjata Materiale (AAM)-vazhdim

| | *Norma Mesatare Amortizimit %* | *Metoda Llogaritjes* |
|---|---|---|
| Pajisje informatike | 25% | Me vleren e mbetur |
| Mobilje dhe Orendi | 20% | Me vleren e mbetur |
| Makineri dhe pajisje | 20% | Me vleren e mbetur |
| Automjete | 20% | Me vleren e mbetur |
| Ndertesa | 5% | Me vleren e mbetur |

### 3.6 Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Shoqëria zbaton politikat e shtyrjes të shpenzimeve të cilat do të sigurojnë të ardhura në periudhat e mëvonshme. Po ashtu ajo shpërndan në vartësi të përdorimit dhe sigurimit të të ardhurave edhe shpenzimet e parapaguara.

### 3.7 Detyrimet

Shoqëria i klasifikon detyrimet në afatshkurtëra dhe afatgjata.

Detyrimet afatshkurtëra klasifikohen në Detyrime tregtare/Llogari të pagueshme ndaj furnitorëve dhe në detyrime të tjera. Llogaritë e pagueshme dhe detyrimet tregtare të tjera njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas në bilanc paraqiten të vlerësuara me koston e amortizuar.

Detyrimet ndaj shtetit për tatimet dhe për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore jane paraqitur me shumen e tyre te llogaritur sipas kerkesasve ligjore në fuqi më datën e ndërtimit të pasqyrave financiare. Huamarrjet afatshkurtër njihen fillimisht me vlerën e drejtë, pa përfshirë kostot e transaksionit.

Huatë më pas vlerësohen me koston e amortizuar: çdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huasë.

Huatë klasifikohen si detyrime afatshkurtra, me përjashtim në rast se Shoqëria ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit kontabël.

Detyrimet afatgjata vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuara me koston e amortizuar. Cdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huasë duke përdorur metodën e interesit efektiv.

### 3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet

Të ardhurat përfshijnë të ardhurat nga shitja e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë aktivitetin kryesor të shoqërisë, neto nga TVSH dhe nga taksat e tjera. Ato njihen kur ekziston një marrëveshje e vazhdueshme me klientin, dorëzimi është realizuar apo shërbimi është kryer, dhe rreziqet e përfitimet e pronësisë së produktit/shërbimit i janë transferuar klientit, vlera e të ardhurave mund të matet me besueshmëri dhe është e mundur që përfitimet që lidhen me transaksionin mund të hyjnë në Shoqëri.

Të ardhurat nga sherbimet e kryera njihen kur janë kryer sherbimet pavarësisht nëse ato janë faturuar, arkëtuar ose jo.

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëhere kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen. Shoqëria ka zbatuar parimin e krahasimit të të ardhurave me shpenzimet brenda të njëjtës periudhë.

PIRRO ARTISTIC JEWELLERY

Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të ardhura prej tyre pavarësisht nëse janë faturuar apo paguar ato.

### 3.9 Përfitimet e personelit

(i) Kontributet per sigurime shoqerore dhe te ngjashme

Shoqeria, gjate aktivitetit te saj normal, kryen pagesa ne emer te saj dhe te punonjesve te saj per kontributet per sigurimet shoqerore dhe shendetesore ne pajtim me legjislacionin ne fuqi. Kostot perkatese te bera ne emer te Shoqerise ngarkohen ne pasqyren e te ardhurave me ndodhjen e tyre.

### 3.10 Provizionet

Provizioni njihet kur Shoqeria ka nje detyrim aktual qe ka lindur nga nje ngjarje e shkuar, shlyerja e te cilit pritet te shoqerohet me dalje te burimeve dhe mund te behet nje vleresim relativisht i sakte i shumes se detyrimit. Në periudhën raportuese shoqëria nuk ka llogaritur provizione.

### 3.11 Tatimi mbi fitimin

Shoqëria zbaton kërkesat e SKK 11 për tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë mbi fitimin. Shoqëria për llogaritjen e tatimit aktual mbi të ardhurat bazohet në normën e tatimit që përcaktohet në ligjet për tatimet që janë në fuqi në datën e ndërtimit të bilancit kontabël.

Fitimi i tatueshëm është llogaritur duke u bazuar në rezultatin kontabël dhe duke e korigjuar atë me shpenzimet e panjohjura sipas përcaktimit të ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat". Manaxhimi vlerëson periodikisht gjendjen lidhur me tatimin e rimbursueshëm duke u bazuar në situatat në të cilat rregullimet tatimore që zbatohen janë subjekt i interpretimit dhe përcakton provizione kur e shikon të përshtatshme bazuar në shumat që parashikon ti paguajë ndaj zyrës së tatimeve. Shoqëria nuk ka patur diferenca të përkoshme dhe nuk ka njohur tatim të shtyrë në PF të vitit 2018.

## 4. Mjetet monetare

Në këtë grup të aktiveve paraqitet gjendja e mjeteve monetare në llogaritë bankare dhe në arkat e shoqërisë. Konvertimi i gjendjes në monedhë të huaj në arkë dhe bankë është bërë me kursin e datës 31.12.2018 të shpallur nga Banka e Shqipërisë, Diferencat e rezultuara nga rivlerësimi i likuiditeteve në monedhë të huaj janë sistemuar në rezultat. Gjendja e mjeteve monetare dhe te ngjashme në fund të periudhës 2018 paraqitet si vijon:

| Pershkrimi I Llogarive | 31-Dhjetor-18 | 31-Dhjetor-17 |
|---|---|---|
| Mjete monetare në banke | 2,817,388 | 3,665,522 |
| Mjete monetare në arkë | - | 146,779 |
| Total | 2,817,388 | 3,812,301 |

## 5. Kerkesa të arkëtueshme

Në këtë zë paraqiten kërkesat ndaj klientave gjendje të paarkëtuar në 31 Dhjetor 2018. Ato paraqiten me vlerën neto nga zhvlerësimi nga borxhi i keq. Shoqëria nuk ka llogaritur borxh të keq për vitin 2018. Një paraqitje e përbërjes së kërkesave të arkëtueshme ndaj klientave jepet në tabelën vijuese:

PIRRO
ARTISTIC JEWELLERY

## 5. Kerkesa të arkëtueshme -vazhdim

| Pershkrimi I Llogarive | 31-Dhjetor-18 | 31-Dhjetor-17 |
|---|---|---|
| Kliente per sherbime, mallra dhe produkte | 7,814,572 | 5,896,160 |
| Total | 7,814,572 | 5,896,160 |

Dinamika e të drejtave ndaj klientëve paraqitet si vijon:

| Pershkrimi | 2018 |
|---|---|
| **Gjendja 01 Janar** | **5,896,160** |
| Rritjet Gjate periudhes ushtrimore | 111,503,325 |
| Pakesimit gjete periudhes ushtrimore | -109,584,911 |
| **Gjendja 31 Dhjetor** | **7,814,573** |

## 6. Kerkesa të arkëtueshme të tjera

Në këtë zë të bilancit paraqiten kërkesat e shoqërisë ndaj të tretëve që nuk lidhen me shitjen e shërbimeve dhe të mallrave. Ne fund të vitit 2018 një paraqitje e përbërjes e tyre si vijon:

| Pershkrimi i Llogarive | 31-Dhjetor-18 | 31-Dhjetor-17 |
|---|---|---|
| Te Tjera | 46,915 | 801,633 |
| Total | 46,915 | 801,633 |

## 7. Inventaret

Në këtë zë paraqitet vlefta e inventarëve të lëndëve të para dhe produkteve te gatshme gjendje në datën e ndërtimit të PF. Shoqëria prodhon produkte sipas kërkesës së klientëve, dhe gjendja e produkteve te gatshme në fund të vitit 2018 perfaqson vlerën e produkteve të prodhuara për porositë e klientëve, e cila nuk u është faturuar akoma klientëve. Ajo përdor metodën e inventarizimit të periodik për evidentimin në kontabilitet të gjendjes dhe lëvizjes të inventarëve. Inventarët janë vleresuar me kosto, e cila është konsideruar nga drejtimi i shoqërisë si më e vogla e krahasuar me çmimin e parashikuar të shitjes minus shpenzimet e parashikuara të përfundimit të shitjes. (Shiko shen 3.4.) Metoda e kostos së përdorur është metoda e mesatares së ponderuar. Inventarët paraqiten si vijon:

| Pershkrimi I Llogarive | 31-Dhjetor-18 | 31-Dhjetor-17 |
|---|---|---|
| Materiale të para | 37,728,735 | 34,981,428 |
| Produkt i gatshem | 22,475,306 | 21,665,587 |
| Materiale te tjera Inventar I imet | 2,521,168 | - |
| Total | 62,725,209 | 56,647,015 |

## 8. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Paraqesin shumat e shpenzimeve të kryera dhe që do të shpërndahen në periudhat e ardhme.

| Pershkrimi I Llogarive | 31-Dhjetor-18 | 31-Dhjetor-17 |
|---|---|---|
| Shpenzime te periudhave te ardhshme | 123,755 | - |
| Parapagime | - | 2,772,508 |
| Total | 123,755 | 2,772,508 |

## 9. Aktivet Afatgjata

Gjendja dhe shtesat e pakësimet e Aktiveve Afatgjata Materiale dhe e amortizimeve të tyre gjatë vitit 2018 paraqiten si në tabelën vijuese:

**Aktivet Afatgjata Materiale me vlere fillestare 2018**

| Emertimi | Gjendje 31/12/2017 | Shtesa | Pakesime | Gjendje 31/12/2018 |
|---|---|---|---|---|
| 1-Toka | 22,612,350 | | | 22,612,350 |
| 2-Ndertesa | 60,011,560 | 2,205,111 | | 62,216,671 |
| 3-Instalime teknike, makineri, pajisje | 59,404,563 | 2,078,991 | | 61,483,554 |
| 4-Makineri, Pajisje, Aksesor te linjes | 72,292,847 | | | 72,292,847 |
| 5-Pinceta Metalike | 71,405 | | | 71,405 |
| 6-Vegla Pune | 1,502,707 | | | 1,502,707 |
| 7-Mobilje dhe pajisje zyre | 2,218,731 | 35,000 | | 2,253,731 |
| 8-Pajisje informative | 13,619,622 | 124,088 | | 13,743,710 |
| 9-Te tjera | 2,549,638 | | | 2,549,638 |
| 10-Makina | 3,828,960 | | | 3,828,960 |
| **Totali** | **238,112,383** | **4,443,190** | - | **242,555,572** |

### Amortizimi A.A.Materiale 2018

| Emertimi | Gjendje 31/12/2017 | Shtesa | Pakesime | Gjendje 31/12/2018 |
|---|---|---|---|---|
| 1-Toka | - | | | - |
| 2-Ndertesa | 7,160,332 | 2,642,561 | | 9,802,893 |
| 3-Instalime teknike, makineri, pajisje | 26,714,150 | 6,390,946 | | 33,105,096 |
| 4-Makineri, Pajisje, Aksesor te linjes | 28,052,349 | 8,995,236 | | 37,047,585 |
| 5-Pinceta Metalike | 50,248 | 4,231 | | 54,479 |
| 6-Vegla Pune | 328,385 | 234,864 | | 563,249 |
| 7-Mobilje dhe pajisje zyre | 852,285 | 273,289 | | 1,125,574 |
| 8-Pajisje informative | 7,837,725 | 1,445,474 | | 9,283,199 |
| 9-Te tjera | 1,081,817 | 293,564 | | 1,375,381 |
| 10-Makina | | 765,792 | | 765,792 |
| **Totali** | **72,077,289** | **21,045,959** | - | **93,123,248** |

**Vlera Kontabel Neto e A.A.Materiale 2018**

| Emertimi | Gjendje 31/12/2017 | Shtesa | Pakesime | Gjendje 31/12/2018 |
|---|---|---|---|---|
| 1-Toka | 22,612,350 | | | 22,612,350 |
| 2-Ndertesa | 52,851,227 | | | 52,413,777 |
| 3-Instalime teknike, makineri, pajisje | 31,954,731 | | | 28,378,458 |
| 4-Makineri, Pajisje, Aksesor te linjes | 44,976,180 | | | 35,245,262 |
| 5-Pinceta Metalike | 21,157 | | | 16,926 |
| 6-Vegla Pune | 1,174,322 | | | 939,458 |
| 7-Mobilje dhe pajisje zyre | 1,366,446 | | | 1,128,157 |
| 8-Pajisje informative | 5,781,897 | | | 4,460,511 |
| 9-Te tjera | 1,467,821 | | | 1,174,257 |
| 10-Makina | 3,828,960 | | | 3,063,168 |
| **Totali** | **166,035,092** | - | - | **149,432,324** |

## 9. Aktivet Afatgjata-vazhdim

Në bilanc Aktivet Afatgjata paraqiten për çdo grup me vlerën neto pa amortizimin e akumuluar.

Llogaritja e amortizimit të AAM është bërë duke marre parasysh kohën e hyrjes së AAM. Normat e amortizimit të përdorura (referoju shënimit 3.5 (ii)), janë në përputhje me kërkesat e SKK 4 për të siguruar një shpërndarje të saktë të kostos së AAM në koston e periudhave që ato përdoren për sigurimin e të ardhurave.

## 10. Huat dhe obligacionet afatshkurtra

Paraqet tepricen e llogarise se overdraftit bankar afatshkurter ne Euro qe ka marre shoqeria per plotesimin e nevojave te saj afatshkurtera. Gjendja e tij ne fund te vitit 2018 eshte e konvertuar me kursin e dates se fundit te vitit, dhe diferencat jane kaluar ne rezultat. Shuma e ketij zeri paraqitet si vijon:

| Pershkrimi | 31-Dhjetor-18 |
|---|---|
| Huat afatshkurter - Overdraft | 11,944,515 |
| **Total** | **11,944,515** |

## 11.Të pagueshme ndaj furnitorëve

Në këtë zë të bilancit paraqiten detyrimet ndaj furnitorëve ende të papaguara në fund të vitit 2018. Detyrimet ndaj furnitorëve në monedha të huaja janë konvertuar me kursin e datës së fundit të vitit dhe diferencat kanë kaluar në rezultat. Përbërja e këtyre detyrimeve paraqiten si vijon:

| Pershkrimi | 31-Dhjetor-18 | 31-Dhjetor-17 |
|---|---|---|
| Furnitore | 5,675,595 | 3,080,189 |
| **Total** | **5,675,595** | **3,080,189** |

Në furnitorët e aktivitetit kryesor peshën kryesore e zënë detyrimi ndaj furnitorëve për blerjen (importimin) e mallrave për aktivitetin kryesor të shoqërisë.

Dinamika e detyrimeve ndaj furnitorëve paraqitet si vijon:

| Pershkrimi | 2018 |
|---|---|
| **Gjendja më 1 Janar** | **3,080,189** |
| Rritjet Gjate periudhes ushtrimore | 68,768,717 |
| Pakesimit gjate periudhes ushtrimore | -66,173,310 |
| **Gjendja më 31 Dhjetor** | **5,675,596** |

## 12. Të pagueshme ndaj punonjësve

Në datën 31 dhjetor 2018 shoqëria ka detyrim për paga si vijon, te cilat jane shlyer ne Janar 2019.

| Pershkrimi | 31-Dhjetor-18 | 31-Dhjetor-17 |
|---|---|---|
| Detyrime per paga punonjesit | 1,003,783 | 948,602 |
| **Total** | **1,003,783** | **948,602** |

## 13. Detyrimet tatimore

Në këtë paraqiten detyrimet ndaj shtetit për Tatimet e taksat si dhe detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore gjendje të papaguara më 31 dhjetor 2018 dhe që janë paguar në vitin 2019. Një paraqitje e përbërjes së këtij zëri jepet në tabelën vijuese:

| Pershkrimi | 31-Dhjetor-18 |
|---|---|
| Shteti Sigurimet Shoqerore e Shendetsore & TAP | 303,594 |
| Shteti TVSH e Pagueshme | 991,409 |
| Detyrim Tatim mbi fitimin | 156,421 |
| Tatimi ne Burim | 37,853 |
| **Total** | **1,489,277** |

## 14. Hua të tjera

Në këtë zë të DASH paraqiten shumat per financimin e ortakut per nevoja te shoqerise.

## 15. Hua të tjera afatgjata

Ky zë të DAGJ paraqet shumën e huas afatgjatë që shoqëria ka marrë sipas marrëveshjes që ka me banken dhe me te trete te tjere.

| Pershkrimi | 31-Dhjetor-18 | 31-Dhjetor-17 |
|---|---|---|
| Huamarrje të tjera afatgjata - Banka | 9,497,808 | 34,879,596 |
| Hua te tjera | 41,128,000 | 41,128,000 |
| **Total** | **50,625,808** | **76,007,596** |

## 16. Kapitalet e veta

Gjendja e kapitaleve të veta më 31 dhjetor 2018, sipas zërave kryesorë të tyre të paraqitura në bilancin kontabël paraqitet si vijon:

| Pershkrimi | 31-Dhjetor-18 | 31-Dhjetor-17 |
|---|---|---|
| Kapitali i paguar | 61,000,000 | 61,000,000 |
| Fitimi (Humbja) i/e vitit te kaluar | 28,095,695 | 24,465,447 |
| Fitimi (Humbja) i/e vitit financiar | 2,542,432 | 3,630,248 |
| Rezerva ligjore | 9,752,179 | 9,752,179 |
| Rezerva të tjera | 79,542 | 79,542 |
| **Total** | **101,469,848** | **98,927,417** |

## 17. Të ardhurat

Shoqëria i ka paraqitur të ardhurat dhe shpenzimet duke ndërtuar Pasqyrën e të ardhurave sipas natyrës.

| Pershkrimi | 31-Dhjetor-18 | 31-Dhjetor-17 |
|---|---|---|
| Te ardhura nga shitja e produktit dhe punimeve | 100,531,261 | 106,377,215 |
| **Total** | **100,531,261** | **106,377,215** |

PIRRO ARTISTIC JEWELLERY

## 17.1 Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit

Shuma e këtij zëri paraqitet si vijon:

| Pershkrimi | 31-Dhjetor-18 |
|---|---|
| Gjendje fillestare - Prudukt I gatshem | -21,665,587 |
| Gjendje perfundimtare Produkt I gatshem | 22,475,306 |
| **Ndryshim gjendje produktesh** | **809,719** |

## 17.2 Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatëshme dhe prodhimit në proces

Shuma e këtij zëri paraqet ndryshimin e vlerës se prodhimit në proces ne vitin 2018 e cila përfundon në vitin 2019 si dhe te ndryshimit te PG. Si rezultat në datë 31.12.2018 kjo është gjëndje në librat e shoqërisë dhe është paraqitur në këtë zë.

## 18. Materiale te konsumuara ( KMSH)

Ne kete ze perfshihen kostoja e mallrave te shitur si dhe kostoja e materialeve te perdorura per ambalazhinin e tyre gjate vitit ushtrimor. Ne koston e materialeve te para shoqeria ka ngarkuar te gjitha kostot direkte te tyre qe sherbejne per te siguruar keto materiale, si taksa doganore, shpenzime transporti, etj. Permbajtja paraqitet si vijon:

| Pershkrimi | 31-Dhjetor-18 |
|---|---|
| Blerje materiale të para | 39,663,300 |
| Blerje materiale të tjera ndihmese | 2,481,526 |
| **Total** | **42,144,826** |

## 19. Shpenzime personeli

Në shpenzimet për personelin, janë përfshirë shpenzimet për paga, shpërblime dhe sigurime shoqërore e shëndetësore të llogaritura gjatë vitit 2018. Gjatë vitit 2018 shoqëria ka llogaritur, deklaruar dhe paguar në përputhje me kërkesat ligjore tatimin mbi pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetsore për punonjësit. Përbërja e shpenzimeve të pagave paraqitet si vijon:

| Pershkrimi | 31-Dhjetor-18 | 31-Dhjetor-17 |
|---|---|---|
| Shpenzime per paga | 12,378,070 | 13,327,548 |
| Shpenzimet e sigurimeve shoqerore e shendetsore | 2,056,929 | 2,216,629 |
| **Total** | **14,434,999** | **15,544,177** |

Në nënzërin e shpenzimeve për sigurimet shoqërore e shëndetsore paraqiten shuma e kontributeve që llogarit dhe paguan shoqëria mbi fondin e pagave të punonjësve. Kontributet janë llogaritur në përputhje me tarifat dhe mënyrën e parashikuar nga ligji i kontributeve shoqërore e shëndestore.

PIRRO
ARTISTIC JEWELLERY

## 20. Shpenzimet e tjera

Përbërja e këtij zëri të shpenzimeve paraqitet si vijon:

| Pershkrimi | 31-Dhjetor-18 |
|---|---|
| Qira | 6,574,923 |
| Blerje,energji,avull,uje | 361,187 |
| Shpenzime transpoti dhe te ngjashme | 119,100 |
| Shpenzime komisione bankare | 1,262,680 |
| Sigurime mallra, magazina, njësi prodhimi | 671,891 |
| Sigurime njësi administrative (ruajtje objekti) | 675,000 |
| Shpenzime telefoni, internet, dhe te ngjashme | 762,450 |
| Mirëmbajtje dhe riparime | 754,416 |
| Shpenzime per taksat vendore & doganore | 1,735,614 |
| Sherbime Konsulence, sherbime nga te trete, | 1,045,806 |
| Shpenzime kancelari dhe te tjera personeli | 558,697 |
| Te tjera | 4,712,828 |
| Transferime, udhëtime, dieta | 426,598 |
| Diferenca kursi kembimi furnitore, kliente dhe te trete te tjere | -167,311 |
| **Total** | **19,493,877** |

Shpenzimet e qirasë paraqesin qiranë e ambjentit ku ushtron aktivitet shoqeria. Shpenzimet e konsulencës dhe nga të tretët paraqesin kostot e shërbimeve, reklamave, etj. Shpenzimet e tjera, paraqesin pagesat për blerjen e ujit, blerje te ndryshme te tjera, etj.

## 21. Të ardhurat dhe shpenzime për interesa

Përbërja e këtij zëri paraqitet si vijon:

| Pershkrimi | 31-Dhjetor-18 | 31-Dhjetor-17 |
|---|---|---|
| Te Ardhura nga Interesi | 785 | - |
| Shpenzime nga Interesi | (1,483,199) | (1,170,563) |
| **Total** | **(1,482,414)** | **(1,170,563)** |

## 22. Fitimet dhe humbjet nga këmbimi

Paraqesin fitimet dhe humbjet e vërtetuara gjatë vitit nga kryerja e transaksioneve në monedhë të huaj si dhe nga konvertimi në lekë me kursin e fundit të vitit e gjendjeve të likuiditeteve të shprehura në monedhë të huaj. Paraqitja e tyre jepet në tabelën vijuese:

| Pershkrimi | | 31-Dhjetor-18 |
|---|---|---|
| *Fitimi nga Kurset e kembimit* | | |
| | Fitime nga azhornimi i Arkes/Bankes | 1,180,811 |
| *Humbje nga Kurset e kembimit* | | |
| | Humbje nga azhornimi i Arkes/Bankes | (98,122) |
| | **Total** | **1,082,689** |

PIRRO ARTISTIC JEWELLERY

## 23. Tatimi aktual

Shoqëria ka rezultuar me një fitim kontabël 3,821,595 lekë. Gjatë vitit ushtrimor 2018 shoqëria ka bërë shpenzime të konsideruara të panjohura për qëllime fiskale ne shumën 4,706,156 leke. Fitimi fiskal i shoqërisë për vitin 2018 rezulton 8,527,751 lekë. Llogaritja e rezultatit fiskal dhe e tatimit mbi fitimin për gjithë vitin 2018 paraqiten si në tabelën vijuese:

| | | |
|---|---|---|
| **Pasqyra e rezultatit tatimor** | | **Viti 2018** |
| **Fitimi/Humbja e vitit** | | **3,821,595** |
| **Korigjimet e rezultatit sipas ligjit tatimor:** | | **4,706,156** |
| **Shpenzime me dok jo të rregullta** | | 4,706,156 |
| *Shpenzime të tjera* | *4,525,341* | |
| *Gjoba Penalitete e te ngjashme* | *180,815* | |
| **Totali i shpenzimeve të panjohura** | | **4,706,156** |
| **Fitimi/Humbja i tatueshem para mbartjes se humbjes fiskale** | | 8,527,751 |
| Humbja fiskale nga viti | | |
| Fitimi/Humbja fiskale e vitit | | **8,527,751** |
| Norma e tatimit aktual mbi fitimin | | 15% |
| Tatimi aktual mbi fitimin e vitit | | 1,279,163 |
| **Shpenzimi kontabel i tatimit mbi fitimin** | | **1,279,163** |

Shoqëria përdor norma amortizimi sa normat tatimore (referoju shënimit 3.5 (ii)).

## 24. Ngjarjet mbas datës së bilancit

Nuk ka në dijeninë e drejtimit, ngjarje të rëndësishme pas datës së bilancit që do të ishte e nevojshme që të paraqiteshin si rregullime ose informacione shtesë në këto pasqyra financiare.

PIRRO
ARTISTIC JEWELLERY